Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 319/20
Datë/Datum. 11.06.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

DATË/A:	**11 qershor 2020**
REFERENCË:	**319/20**
PËR/ZA/TO:	**AK- Kuvendi Komunal Prizren**
NGA/OD/FROM:	**Goran Milenkovic** **Kryetar i panelit shqyrtues- OSHP**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**NJOFTIM**

Operatori ekonomik "SFINGA" sh.p.k-Prizren, si palë e pakënaqur me datën: 21 maj 2020, ka parashtruar në OSHP ankesën me numër 319/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Krijimi dhe mirëmbajtja e brendit për qytetin e Prizrenit" me numër të prokurimit: 622-20-923-2-2-1, duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- Neni 69 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimit të anekses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 26 maj 2020 kanë autorizuar eksperten shqyrtuese të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Ekspertja shqyrtuese me datën 05 qershor 2020 ka dorëzuar raportin e ekspertizës dhe ka konstatuar që ankesa e OE ankues te aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa vendimi i AK-se për dhënie te kontratës te anulohet dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

Autoriteti kontraktues- Kuvendi Komunal Prizren me datën 05 qershor 2020 kanë pranuar mendimin e ekspertit shqyrtues dhe të njëjtit me datën 08 qershor 2020 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik ankues me datën 05 qershor 2020 ka pranuar nga OSHP raportin e ekspertizës dhe të njëjtit përmes parashtresës me shkrim me datën 08 qershor 2020 kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së që **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti kontraktues- Kuvendi Komunal Prizren për aktivitetin e prokurimit "Krijimi dhe mirëmbajtja e brendit për qytetin e Prizrenit" me numër të prokurimit: 622-20-923-2-2-1, duhet të anuloj njoftimin mbi vendimin e AK-së, për dhënie dhe lënda të kthehet ne **rivlerësim**, konform mendimit te dhënë ne raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatorit ekonomik "SFINGA" sh.p.k-Prizren konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Përbërja e panelit shqyrtues të OSHP-së:

z. Goran Milenkovic----------Kryetar i panelit shqyrtues

z. Nuhi Paçarizi---------- Referues

z. Blerim Dina---------- Anëtar